

1 E mërkurë, 9 mars 2022

2 [Konferencë Përgatitore për Mbrojtjen dhe
3 Konferencë për Ecurinë e Çështjes së Viktima
4 [Seancë e hapur]

5 [I akuzuari merr pjesë përmes videolidhjes]

6 --- Seanca fillon në orën 14.31

7 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

8 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Mirëdita, të nderuar
9 Gjykatës. Kjo është çështja KSC-BC-2020-05. Prokurori i
10 Specializuar kundër Salih Mustafës.

11 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

12 Faleminderit.

13 Tani do të shohim kush janë të pranishëm në sallë.

14 Z. Prokuror a mund të na thoni kush është i pranishëm nga
15 Prokuroria sot.

16 Z. MICHALCZUK: [Përkthim] Po, sigurisht. Mirëdita të
17 gjithëve. Prokuroria sot përfaqësohet nga Silvia D'Ascoli,
18 Prokurore e Asociuar; Julie Mann, menaxhere e çështjes; dhe
19 unë Cezary Michalczuk, Prokuror.

20 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

21 Faleminderit.

22 Vërej se Avokatja e Viktimave është lidhur përmes
23 videolidhjes. A na dëgjoni? A është në rregull lidhja avokate?

24 ZNJ. PUES: [Përkthim] [Përmes videolidhjes] Përshëndetje,
25 po. Mirëdita të gjithëve. Ju dëgjoj shumë mirë. Shoh shumë

1 mirë dhe mund të konfirmoj që ne jemi nga ekipi jonë, Anni

2 Pues, avokate dhe gjithashtu dhe bashkëavokatja.

3 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

4 Faleminderit. Tani z. avokat i Mbrojtjes e keni ju fjalën.

5 Z. VON BONE: [Përkthim] Përshëndetje. Mbrojtja

6 përfaqësohet nga unë, Julius von Bone; Z. Betim Shala,

7 bashkëmbrojtës dhe Fatmir Pelaj, hetues dhe përkthyer.

8 Po ashtu i lidhur me neve nga larg po ashtu është z.

9 Mustafa.

10 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Z.

11 Mustafa, na dëgjoni? Punon siç duhet lidhja? Na dëgjoni?

12 I AKUZUARI: [Përmes videolidhjes] Po, znj. Gjykatëse.

13 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Shumë

14 mirë. Për Zyrën Administrative?

15 Z. NILSSON: [Përkthim] Përshëndetje, mirëdita të nderuar

16 Gjykatës, kolegë. Unë jam z. Jonas Nilsson, nga Zyra

17 Administrative.

18 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

19 Faleminderit.

20 Jemi përpara Trupit Gjykses I.

21 Tani po vazhdojmë me këtë seancë ku Trupi Gjykses do të

22 japë disa urdhra gojore në përputhje me rregullën përkatëse të

23 Rregullores.

24 Por përpara se sa t'i japim këto urdhra gojorë duam që të

25 dëgjojmë palët lidhur me çështjen që është ngritur sot dërguar

1 përmes emailit në orën 11.34 paradite. Në këtë email u kërkua
2 që të bëhen parashtrime lidhur me një prej dëshmitarëve. Po
3 ashtu, Trupi Gjykses ju bën ftesë ZPS-së dhe Mbrojtjes që të
4 bëjnë parashtrimet përkatëse në qoftë se dëshirojnë t'i bëjnë
5 këto parashtrime tani.

6 Mbrojtja e keni ju fjalën tani.

7 Z. VON BONE: [Përkthim] Përshëndetje të nderuar Gjykatës,
8 nuk do t'ju marr shumë kohë.

9 Megjithatë, më lejoni që të filloj me zotërinë i cili ka
10 numrin 100, dëshmitari 100. Pra, ai nuk mund të thotë asgjë sa
11 i takon akuzave specifike, sepse ai nuk është se ai ka qenë i
12 pranishëm me z. Mustafa ose në terren atje.

13 Megjithatë, ne mendoj se ai është një dëshmitar i
14 rëndësishëm sepse mund të japë informacion për kontekstin e
15 konfliktit dhe do të na bëjë të mundur se si të kuptojmë se
16 është kuptuar ky rast nga popullsia e përgjithshme në Kosovë.
17 Ai është anëtar -- ka qenë anëtar i Shtabit të Përgjithshëm,
18 kështu që ka një njohuri të mirë të përgjithshme lidhur me atë
19 çfarë ka ndodhur në zonat operative. Në të njëjtën kohë ai ka
20 marrë pjesë në takime, kështu që në këtë kuadër mund të thotë
21 diçka lidhur me përmbushjen e zinxhirit të komandës dhe
22 urdhrat dhe kujt i janë dhënë këto urdhra. Si dhe në çfarë
23 mënyre, pra ka pasur komente për përmbushjen e tyre.

24 Si shef i departamentit për marrëdhëniet publike dhe
25 civile, ai ka qenë në pozitë që të kishte informacion të mirë

1 dhe të kishte kontakte të mira lidhur me çfarë ka ndodhur në
2 aspektin civil. Kështu që ne mendojmë që ai do të ketë mundësi
3 që të japë dëshmi kryesisht në zonën civile të Prishtinës që
4 ka funksionuar në atë kohë.

5 Mendojmë se ky zotëri ka qenë në pozitë shumë të mirë që
6 të dëgjojë, që të marrë komente nga popullsia civile sa i
7 takon shumë gjërave të ndryshme, përfshirë gjithashtu edhe
8 faktin në qoftë se do të ishin ndaluar njerëzit, ku do të
9 ishin ndaluar ata, apo se çfarë pretendimesh do të kishin bërë
10 sa i takon njerëzve të cilët ishin zhdukur në atë kohë apo në
11 një periudhë të caktuar. Dhe sigurisht për neve veçanërisht
12 është me rëndësi periudha nga 1 deri me 18 ose 20 prill.

13 Pra, ne besojmë se edhe pse ky zotëri nuk është një
14 person strikt apo rreptësisht i lidhur me atë çfarë ka
15 ndodhur, mendojmë se ai mund të japë një kontekst të
16 rëndësishëm me vlerë për Trupin Gjykses. Të nderuar Gjykatës,
17 ne mendojmë që në momentin aktual ne nuk kemi kontekstin e
18 nevojshëm nga pozita e personave që vijnë nga Komanda e
19 Përgjithshme. Kështu që besojmë që është shumë me rëndësi për
20 neve që të kemi në dëshmitar të tillë.

21 Tani le të kalojmë te dëshmitari tjetër, tek zotëria
22 tjetër që është dëshmitari me numër 1800. Ky është një person
23 i cili është plagosur në afërsi të Zllashit dhe që është
24 trajtuar në Zllash dhe ne besojmë që është trajtuar në vendin
25 që ka të bëjë me akuzat e ngritura. Në fakt, në qoftë se

1 konteksti i dhënë në këtë moment nga Prokuroria lidhur me këtë
2 vend, mendojmë që është kyç, është shumë i rëndësishëm për të
3 gjithë çështjen. Pra ky është një vend i cili është menaxhuar,
4 administruar nga BIA dhe i takon që këta do të ishin personat
5 përgjegjës për të e kështu me radhë.

6 Pra, ne besojmë se ky person dhe mendojmë që puna e bërë
7 në atë vend -- ose ndoshta "puna" nuk është fjala e
8 përshtatshme në këtë kuadër, por trajtimi i të plagosurve,
9 ishte një prej gjërave të bëra. Ky është një person i cili
10 gjithashtu ka marrë pjesë në luftimet që kanë çuar në ofensivë
11 dhe mendojmë që ky është person i cili është në pozitën e
12 duhur për të diskutuar, për të folur për ofensivën. Kur ka
13 filluar ofensiva, si është zhvilluar ajo dhe ku ka ndodhur, ku
14 ka qenë lokacioni apo vendi i ndodhjes së saj.

15 Pra, vendndodhja kryesore janë Zllash dhe Mramor. Këto
16 janë dy vendndodhjet kryesore. Ne përcaktojmë Zllashin ose e
17 vendosim Zllashin si pjesë e Mramorit, për ndërkohë Mramori
18 është një vend tjetër. Është një fshat i ndryshëm nga vendi që
19 ne diskutojmë në kuadër të akuzave, për sa i takon kompleksit
20 që është pjesë e akuzave.

21 Ky është një person i cili është trajtuar në atë kohë nga
22 dy persona të tjerë dhe këta janë dëshmitarët 1600 dhe 1700.
23 Pra, kemi dy persona të cilët janë trajtuar nga pikëpamja
24 profesionale dhe kemi personin e tretë, i cili është pacienti,
25 në qoftë se mund të shprehem kështu. Pra, ne besojmë që ata

1 kanë qenë në të njëjtin vend për të cilin flasim ne. Ata do të
2 japim një këndvështrim tërësisht tjetër lidhur me arsyen e
3 përdorimit të ndërtesave në kompleks. Kush ishte përgjegjës,
4 kush ishte i pranishëm aty, etj. Domethënë ky është një ndër
5 personat të cilët ne mendojmë që ja vlen të merret në pyetje.

6 Ndërkohë që personi tjetër, e nderuar Gjykatëse, është
7 dëshmitari me numër 2000. Në dosjen e paragjyimit që u
8 përmend nga ZPS-ja thuhet që BIA ka menaxhuar këtë qendrën e
9 ndalimit në Zonën Operative të Llapit. Ne besojmë që kjo nuk
10 është absolutisht rasti. Në rastin e këtij dëshmitari ne kemi
11 një person i cili ka qenë oficer i policisë ushtarake. Ka qenë
12 pjesë e komandës së policisë ushtarake dhe ka qenë përgjegjës
13 si dhe ka punuar gjithashtu me qendrën e ndalimit të gjendur
14 në zonën e Llapashticës. Në dëshminë e tij është e qartë se si
15 ai e ka dokumentuar këtë gjë dhe ne besojmë se ai nuk ka
16 kontaktuar asnjëherë as me ndonjë person të BIA-s apo një
17 person tjetër që do të ishte dërguar nga BIA në atë qendër
18 përkatëse ndalimi për të cilën ishte përgjegjës ky person.

19 Ai është shumë i qartë lidhur me të gjitha mënyrat dhe
20 mjetet e përdorura nga policia ushtarake dhe që janë përdorur
21 në kuadër të kësaj qendre ndalimi.

22 Ndërkohë i vetmi person që ne kemi gjetur dhe përderisa
23 ne po flasim këtu për qendrën e ndalimit, për kompleksin e
24 ndalimit, domethënë, duam të dimë në qoftë se ka pasur një
25 kompleks ndalimi, ku ka qenë, ka qenë në Llapashticë, ka pasur

1 vetëm një qendër të tillë apo ka pasur edhe qendra të tilla.

2 Ky është qëllimi i këtij personi. Pra që të shpjegojë apo që
3 të thotë qartësisht hollësitë e lidhura me këtë.

4 Pra si anëtar i policisë ushtarake, pa diskutim që ai ka
5 qenë në dijeni të rolit të kompetencave të policisë ushtarake
6 dhe personave të tjerë që do të kishin kompetenca ose nuk do
7 të kishin fare kompetenca, as për të arrestuar, për të ndaluar
8 apo për të lehtësuar çdo lloj kompleksi ndalimi.

9 Për neve gjëja më e rëndësishme në këtë çështje është se
10 z. Mustafa akuzohet për këto krime. Pra, kryesisht akuzohet se
11 ka ndaluar njerëzit, i ka mbajtur ata në kushte të caktuara, i
12 ka torturuar ata ose i ka keqtrajtuar, maltruar ata në mënyra
13 të ndryshme. Ndërkohë që pozicioni ynë është që neve nuk
14 besojmë z. Mustafa ka pasur ndonjë gjë me ndonjërin prej
15 këtyre akuzave. Dhe ai është shumë i qartë në këtë mohim. Ai
16 nuk ka lidhje fare me të dhe ai nuk duhet të shpallet fajtor
17 për këto akuza. Ne besojmë fort që ai është një person i
18 pafajshëm dhe në fakt nuk ka pasur të bëjë fare me asnjë lloj
19 ndalimi, të asnjë prej viktimave apo personave të cilët mund
20 të jenë ndaluar në një pikë të caktuar kohe dhe që kanë
21 dëshmuar në këtë çështje. Pra në qoftë se ka pasur ndonjë lloj
22 ndalimi, do të duhet të dimë se ku ka qenë ndalimi, si ka
23 funksionuar UÇK-ja, si është rregulluar ajo dhe duhet të
24 shohim gjithashtu në qoftë se ka pasur njerëz në këtë qendër
25 specifike ndalimi ku ky burri ka qenë - domethënë, në qoftë se

1 ai ka koordinuar ose organizuar dhe për cilën arsye do të
2 ishin ndaluar persona të tillë.

3 Domethënë këto janë parashtrimet tona. Këto janë
4 argumentet që kemi lidhur me këto tri tema. Dhe kaq kisha për
5 të thënë.

6 Faleminderit për vëmendjen.

7 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

8 Faleminderit avokat.

9 Shikoj në të djathtën time, nuk e di në qoftë se ka
10 ndonjë pyetje?

11 Atëherë z. Prokuror a doni të ngrini diçka lidhur me këtë
12 element?

13 Z. MICHALCZUK: [Përkthim] Po, të nderuar Gjykatës, kam
14 disa koment lidhur me këtë pikë.

15 Unë nuk do të përsëris edhe një herë argumentet që i kemi
16 vënë në parashtrimet tona më datë 7 mars 2022, me parashtrimin
17 e protokolluar me numër F003338. Në këtë parashtrim ne i jemi
18 referuar dëshmitarit numër 100 dhe dëshmitarit 1800 dhe në
19 këto parashtrime kemi thënë se pasi i kemi rishikuar
20 deklaratat që i janë dhënë Mbrojtjes, neve mendojmë që në fakt
21 vlera e deklarimeve të tyre është e vogël lidhur me këtë
22 çështje, është skajore.

23 Do të doja që t'i diskutoja këto elemente njëra pas
24 tjetrës, shumë shkurtimisht.

25 Sa i takon dëshmitarit 100, dëshmitari flet për shumë

1 çështje të cilat janë shumë interesante. Sigurisht që japin
2 një kontekst të caktuar historik. Flet gjerësisht për
3 konferencën e Rambujesë, rolin e vet në UÇK. Megjithatë, të
4 nderuar Gjykatës, ne besojmë që përderisa kemi vendimin e
5 Panelit, e Trupit Gjykues sa i takon fakteve, objekt i
6 gjykimit, pjesa më e madhe e gjërave që ka të bëjë me UÇK-në,
7 me strukturën, ekzistencën ose zinxhirin e komandës, pra të
8 gjitha këto i kemi në këtë vendim të Trupit Gjykues. I
9 referohem konkretisht vendimit të Trupit Gjykues datë 7
10 shtator 2020, numër KSC dhe dokumenti pra mban numrin KSC-BC-
11 2020-05, F00191.

12 Në përmbledhje, ne nuk mendojmë që ja vlen që të
13 thërritet ky dëshmitar për të dhënë dëshmi në emër të
14 Mbrojtjes dhe nuk mendojmë që mosdëshmia e tij nuk është se
15 dëmton të akuzuarin në asnjë mënyrë.

16 Sa i takon dëshmitarit të dytë, që është dëshmitari numër
17 1800, e kemi rishikuar edhe një herë deklaratën e mbrojtjes
18 përpara seancës së ditës së sotme dhe besojmë që vlera e
19 dëshmisë së këtij dëshmitari është sërish e vogël për sa i
20 takon lëndës në fjalë. Sërish, ai nuk përmend që i akuzuari ka
21 qenë aty dhe flet vetëm për faktin që dikur është plagosur.
22 Kam përshtypjen që është plagosur në datën 18 prill që është
23 thuajse drejt fundit të kësaj periudhe. Dhe thotë më pas që ai
24 është trajtuar në Zllash prej njërit nga dëshmitarët që është
25 propozuar nga Mbrojtja. Megjithatë, këtë dëshmitar ne nuk e

1 kundërshtojmë, sepse ky është një dëshmitar i cili mund të
2 flasë për këtë rrethanë dhe megjithatë kjo është një rrethanë
3 e cila nuk është e lidhur ngushtë me çështjen në fjalë, kështu
4 që mendoj se nuk thërritet për të dëshmuar ky dëshmitar, kjo
5 nuk cenon, nuk dëmton të akuzuarin.

6 Ndërkohë në qoftë se do t'i referohemi dëshmitarit të
7 fundit që është objekt diskutimi sot, është dëshmitari me
8 numrin 2000, ai ka qenë oficer i policisë ushtarake në
9 Llapashticë. Ai flet për pozicionet e veta dhe për përvojën e
10 vet në këtë vend. Ndërkohë ai nuk e përmend fare Zllashin.
11 Vetëm në një rresht thotë se ka qenë në Zllash në vitin 2018.
12 Domethënë shumë vite pasi ngjarjeve të cilat janë me interes
13 për ne. Ai nuk e përmend të akuzuarin në kontekstin e
14 konfliktit, por thotë dhe është takuar me të vetëm pas luftës,
15 kështu që duke pasur parasysh çfarë ka thënë ai, besojmë se
16 dëshmia që do të jepet nga ky dëshmitar sërish ka rëndësi të
17 vogël.

18 Rëndësia e këtij dëshmitari mund të jetë vetëm
19 rrethanore, por megjithatë nuk është e lidhur me akuzat të
20 cilat janë ngritur kundër të akuzuarit në këtë çështje. Pra ky
21 është këndvështrimi ynë dhe këtë pozicion e kemi bërë shumë të
22 qartë edhe në parashtrimet që kemi dorëzuar para kësaj seance.
23 Ne nuk mendojmë që ky dëshmitar duhet të thërritet. Dhe sërish
24 edhe fakti që nuk do të thërrasim ose nuk thërritet një
25 dëshmitar i tillë, dëshmia e këtij dëshmitari nuk e dëmton

1 çështjen e Mbrojtjes.

2 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

3 Faleminderit z. Prokuror.

4 Dëshmitarja e Viktimave [sipas përkthimit] keni për të
5 bërë ndonjë konstatim.

6 ZNJ. PUES: [Përkthim] [Përmes videolidhjes] Faleminderit
7 të nderuar Gjykatës. Vetëm shkurtimisht.

8 Dua të them që mbështes atë që u shpjegua prej ZPS-së dhe
9 dëshiroj që të shtoj diçka të fundit që ka të bëjë me
10 dëshmitarin e fundit që u diskutua nga të dyja palët, që është
11 dëshmitari 2000. Për mua aspekti më i rëndësishëm është që ai
12 ka thënë që ka dëgjuar për njësinë BIA vetëm pas luftës. Mua
13 kjo më sugjeron fort se duke pasur parasysh faktin që Mbrojtja
14 nuk ka ngritur ndonjë dyshim për ekzistencën e BIA-s, ai nuk
15 është personi i përshtatshëm për të na treguar neve se çfarë
16 ka bërë një njësi e tillë dhe çfarë ka bërë i akuzuari si
17 pjesë e kësaj njësie, pra e njësisë BIA.

18 Faleminderit.

19 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

20 Faleminderit, Mbrojtësja e Viktimave.

21 Në qoftë se është e nevojshme dua t'ju jap një raund të
22 dytë. Nuk e di avokati mbrojtës në qoftë se doni të thoni
23 diçka tjetër.

24 Z. VON BONE: [Përkthim] Shumë shkurtimisht, të nderuar
25 Gjykatës.

1 Ne besojmë pikës së pari që është shumë e rëndësishme që
2 të ofrohet kontekst për tërësinë e konfliktit për të gjithë
3 konfliktin. Është e rëndësishme që të japim kontekst edhe nga
4 pikëpamja e civilëve. Dhe këtë do ta marrim nga personi që ka
5 qenë pjesë e Shtabit të Përgjithshëm, ka qenë pjesë e takimeve
6 dhe që është në dijeni të faktit se si kanë shkuar gjërat. Unë
7 nuk mendoj se kjo ka pak rëndësi.

8 Sa i takon dëshmitarit 1800, të nderuar Gjykatës, mendoj
9 që ai e bën panoramën e asaj çfarë është shpjeguar nga
10 dëshmitarët 1600 dhe 1700 të plotë, sepse ai është një person
11 i cili është plagosur, është person i cili ka qenë i pranishëm
12 aty dhe mendoj se ne këtë lloj perspektive nuk e kemi fare.
13 Kështu që besoj që -- pra ne nuk është se kemi një shpjegim të
14 veçantë, nuk është se kemi një ushtar që na ka shpjeguar se si
15 ka qenë ofensiva, si ka funksionuar ajo, cilat janë masat e
16 marra. etj. Kështu që ne flasim për këtë çështje edhe në
17 çështje të tjera të krimeve të luftës, ku -- që janë situata
18 në të cilat njerëzit vdesin apo plagosen.

19 Kemi dëgjuar nga njerëz këtu nga Gjykata dhe kemi dëgjuar
20 perspektivën e personave të cilët kanë qenë viktimat të
21 çfarëdolloj maltrajtimi apo çfarëdolloj gjëje tjetër. Ndërkohë
22 që në këtë rast kemi mundësinë që të dëgjojmë dikë që ka qenë
23 ushtar i UÇK-së, që të na shpjegojë se si ka ndodhur kjo
24 realisht, logjistikisht, domethënë si ka ndodhur ofensiva. Dhe
25 një herë, ky është person i cili është ngushtësisht i lidhur

1 me dëshmitarët 1600 dhe 1700. Mendojmë që dëshmia e tij do ta
2 bëjë më të plotë panoramën dhe mendojmë që këto janë tre
3 dëshmitarë që janë të lidhur me njëri-tjetrin. Kështu që
4 mendojmë që do të ishte e dobishme që t'i kishim ata dhe nuk
5 është dëshmitar i cili do të kërkojë më shumë kohë.
6 Megjithatë, mendoj, -- nuk e di si ta shpreh ekzaktësisht por
7 mendoj që do të mbyllet rrethi, do të mbyllet qarku në qoftë
8 se do të dëgjojmë edhe dëshmitarin e tretë pasi të kemi
9 dëgjuar dy dëshmitarët e parë.

10 Pra, së fundi edhe pse ky person nuk ka qenë ndoshta në
11 Zllash në kohën e aktakuzës, neve marrim përgjigje përmbyllëse
12 për faktin, në qoftë se ka pasur të ndaluar që vinin nga
13 Zllashi dhe ku ishin personat e ndaluar në Llapashticë. Nga
14 vinin ata, kush i ka arrestuar ata, kush e kishte kompetencën
15 që t'i arrestonte personat e ndaluar. Si transferoheshin
16 njerëzit atje. Apo vërtetë ne mendonim që këta ishin persona
17 të cilët ishin në zona të Llapashticës të ndaluar. Pra ne
18 besojmë se kjo jep një komponent të cilin aktualisht nuk është
19 se e kemi deri tani në çështje dhe mendojmë që kjo dëshmi
20 është e rëndësishme.

21 Sigurisht që varet nga juve se çfarë do të vendosni.

22 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

23 Faleminderit avokat.

24 Z. Prokuror, dëshironi të thoni diçka tjetër për t'ju
25 përgjigjur Mbrojtjes, pa përsëritur sigurisht ato çfarë thatë

1 më përpara.

2 Z. MICHALCZUK: [Përkthim] Vetëm shkurtimisht për çështjen
3 e Llapashticës. Prania, ekzistenca e qendrës së ndalimit në
4 Llapashticë nuk përjashton praninë e qendrave të ndalimit në
5 Zllash apo në zona të tjera. Kështu që kam përshtypjen që në
6 qoftë se do të thërrasim dëshmitarin e fundit kjo në fakt do
7 ta çonte shumë më larg diskutimin.

8 Ndërkohë që gjithashtu edhe prania e qendrës së ndalimit
9 në Llapashticë apo qendra të tjera nuk është e kontestuar nga
10 vendimet e mëparshme në çështje nga Kosova, të cilat janë
11 gjykuar nga UNMIK-u ose EULEX-i.

12 Kështu që në përgjithësi, ne vazhdojmë të kemi pozicionin
13 tonë që, është korrekte është gjëja e duhur që të mos pranohen
14 këta dëshmitarë për të dhënë dëshminë e tyre në gjyq sepse ato
15 nuk kanë asnjë vlerë të shtuar.

16 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]
17 Avokatja e Viktimave ka ndonjë gjë për të thënë?

18 ZNJ. PUES: [Përkthim] [Përmes videolidhjes] Jo nuk kam
19 asnjë gjë.

20 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Në
21 rregull.

22 I mbajtëm shënim, i morën parasysh të gjitha parashtrimet
23 tuaja.

24 Ndërkohë që Trupi Gjykes tani do të tërhiqet për sa i
25 takon marrjes së vendimit. Do të mundohemi që ta japim

1 vendimin sa më shpejt që të jetë e mundur, ndërkohë që Njësia
2 për Administrimin Gjyqësor do t'ju informojë në momentin kur
3 të jemi gati për të dhënë urdhrat me gojë.

4 --- Pauza fillon në orën 14.56

5 --- Seanca rifillon në orën 16.10

6 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Do të
7 vazhdojmë me seancën që e ndërpreme pak përpara. Të bëjmë një
8 herë paraqitjen e palëve.

9 Z. Prokuror.

10 Z. MICHALCZUK: [Përkthim] Kemi të njëjtën përbërje.

11 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] E
12 shikoj Mbrojtësen e Viktimave me videolidhje dhe Mbrojtësi i
13 të Akuzuarit dhe ekipi i tij janë këtu me të njëjtën përbërje.

14 Z. Mustafa paraqitet me anë të videolidhjes.

15 Po kështu edhe Zyra Administrative është e paraqitur
16 këtu.

17 Tani do të jap një numër urdhrash me gojë, pasi dëgjova
18 palët dhe Mbrojtësen e Viktimave si me shkrim ashtu edhe me
19 gojë do të jap disa urdhra, si vijon.

20 Urdhri i parë ka të bëjë me paraqitjen e provave të
21 kërkuara nga Mbrojtja e Viktimave.

22 Paneli vëren kërkesën e bërë nga Mbrojtja e Viktimave në
23 parashtrim F297 dhe F334 për të lejuar viktimën 0505 që të
24 paraqesë pikëpamjet e tij para Panelit dhe të caktohet një
25 ekspert për të vlerësuar nga ana mjekësore dëmtimet

1 psikologjike dhe fizike të pësuar nga viktimat 08, 09 dhe 10,
2 si rezultat i torturës, trajtimit mizor dhe ndalimit arbitrar
3 të cilat pretendohet se kanë pësuar.

4 Në lidhje me kërkesën e parë, Trupi Gjykses e quan të
5 përshtatshme të lejojë viktimën 0505 që të japi dëshmi -- jo
6 të japi dëshmi por të paraqitet para Panelit dhe të japi
7 mendimet e veta, të hënën më 21 mars 2022, në orën 09.30.

8 Gjithashtu, Mbrojtja e Viktimave do të lejohet të bëjë
9 parashtrime përpara ose pasi viktimë 0505 të paraqesë
10 shqetësimet e veta, për një orë.

11 Trupi Gjykses specifikon se viktimë 0505 duhet të
12 paraqitet para Trupi Gjykses vetëm me masa mbrojtëse nga
13 publiku siç është parashtruar dhe siç është vendosur në
14 paragrafin 54(e) dhe (f) të Gjykatësit të Procedurë Paraprake
15 që është vendimi i dytë për pjesëmarrjen e viktimave F105 dhe
16 paragrafi 51(f) i vendimit të dytë mbi kërkesën e Prokurorit
17 të Specializuar për masa mbrojtëse F00053.

18 Trupi Gjykses gjithashtu rikujton se në bazë të
19 paragrafit të vendimit mbi të drejtat procedurale të viktimave
20 gjatë gjykimit F00152, paraqitja e pikëpamjeve nga viktimë
21 0505 nuk do t'i nënshtrohet marrjes në pyetje nga palët, vetëm
22 në qoftë se, Paneli, apo Trupi Gjykses e konsideron të
23 nevojshme ta thërrasë këtë viktimë si dëshmitar.

24 Në lidhje me kërkesën e dytë. Trupi Gjykses cakton
25 Institutin mjeko-ligjor holandez për të vlerësuar gjendjen

1 psikiatrike dhe për të vlerësuar dëmtimet fizike dhe
2 psikologjike që kanë vuajtur 08, 09 dhe 10 si rezultat i
3 torturës, trajtimit mizor dhe ndalimit arbitrar që pretendohet
4 se kanë pësuar dhe të përgatisin një raport për këtë.

5 Në lidhje me këtë, instituti i mjekësisë ligjore të
6 Holandës mund të caktojë një ekspert ose më shumë ekspertë që
7 do të kryejnë ekzaminimet e kërkuara psikiatrike, fizike dhe
8 fiziologjike. Raporti do të përmbajë gjithashtu edhe
9 informacion në lidhje me ekspertizën e secilit prej këtyre
10 ekspertëve. Administratorja duhet të bëjë organizimet e duhura
11 për t'u lidhur me Mbrojtjen e Viktimave për të lehtësuar
12 qasjen nga instituti i mjekësisë ligjore të Holandës 08, 09
13 dhe 10.

14 Në qoftë se do të ketë ndonjë vështirësi për zbatimin e
15 këtij urdhri, Zyra Administrative dhe Mbrojtësja e Viktimave
16 duhet të njoftojnë menjëherë Panelin. Raporti do të dorëzohet
17 deri të premten 13 maj 2022 do t'i bëhet i disponueshëm palëve
18 dhe Mbrojtësja e Viktimave me redaktime, në qoftë se është e
19 nevojshme. Trupi Gjykues dhe Mbrojtësja e Viktimave do të
20 marrin edhe një kopje të pa redaktuar të raportit. Dhe pas
21 dorëzimit të raportit procedura e përcaktuar në rregullën
22 149(2) deri (5) do të zbatohet në këtë rast.

23 Vendimi për të caktuar institutin mjekoligjor të Holandës
24 për të kryer ekzaminimin dhe hartuar raportin nuk cenon
25 vendimin përfundimtar të Trupit Gjykues në lidhje me fajësinë

1 apo pafajësinë e të akuzuarit.

2 Me kaq mbyllet urdhri i parë. Urdhri i dytë ka të bëjë me
3 paraqitjen e provave nga Mbrojtja dhe fjalimin apo deklaratën
4 hapëse të Mbrojtjes.

5 Pasi kemi dëgjuar parashtrimet e Mbrojtjes për sa i
6 përket gatishmërisë për të filluar me paraqitjen e provave,
7 Trupi Gjykses përcakton të martën, 22 mars në orën 9.30 si
8 datën për deklaratat hapëse të Mbrojtjes. Mbrojtja do të ketë
9 dy orë për të bërë deklaratën hapëse dhe do të lejohet të
10 përdorë mjete vizuale dhe mjete të tjera, duke përfshirë
11 materiale provuese vetëm në qoftë se këto materiale, përfshirë
12 edhe ERN-në e tyre, i komunikohen Njësisë për Administrimin e
13 Gjykatës, Prokurorisë, Mbrojtjes së Viktimave dhe Trupit
14 Gjykses, sa më shpejt që të jetë e mundur, por jo më vonë se e
15 marta, 15 mars 2020. Çdo kundërshtim për përdorimin e këtyre
16 materialeve duhet të ngrihet me shkrim jo më vonë se 17 mars
17 2022.

18 Për sa i përket paraqitjes së provave, në bazë të
19 rregullës 119(3) të Rregullores, Trupi Gjykses e urdhëron
20 Mbrojtjen të heqë dëshmitarët 100, 1800 dhe 200 nga lista e
21 dëshmitarëve. Vendimi i Panelit në këtë pikëpamje është i
22 mbështetur në deklaratat e këtyre e dëshmitarëve, përmbledhjet
23 e dëshmimeve që do të japin ata dhe parashtrimet që do të bëhen
24 këtu në sallën e gjyqit.

25 Në veçanti, Trupi Gjykses mendon se provat që do të japë

1 -- ose dëshmia që do të japi dëshmitari 100 lidhet me
2 zhvillimet politike në Kosovë dhe nuk përfshihet në
3 juridiksionin kohor të Gjykatës dhe të akuzave ndaj të
4 akuzuarit. Trupi Gjykues mendon që provat kontekstuale nuk do
5 ta ndihmojnë Panelin që të vlerësojë faktet e kësaj çështje.
6 Përveç kësaj, Trupi Gjykues mendon se provat në lidhje me
7 rolin dhe funksionet e këtij dëshmitari në Shtabin e
8 Përgjithshëm të UÇK-së nuk kanë lidhje me shtrirjen kohore,
9 gjeografike dhe materiale të çështjes që po gjykon Paneli.

10 Në lidhje me dëshmitarin 1800, Paneli vë në dukje se
11 provat ose dëshmia që do të japi ai, përsërit deklaratat e të
12 tjerëve, dëshmitarët 1600 dhe 1700. Përveç kësaj Trupi Gjykues
13 vëren se dëshmitari 1800 nuk ka qenë i pranishëm në Zllash në
14 kohën e akuzave dhe përveçse datës 18 prill 1999 dhe nuk jep
15 informacion të rëndësishëm në lidhje me të akuzuarin.

16 Për sa i përket dëshmitarit 2000, dëshmia e tij lidhet me
17 strukturën e policisë ushtarake në Zonën Operative të Llapit
18 në Llapashticë dhe me qendrën e ndalimit atje që nuk
19 përfshihet në juridiksionin e kësaj çështjeje.

20 Përveç kësaj, Trupi Gjykues vëren se dëshmitari e ka
21 takuar të akuzuarin pas ngjarjeve për të cilat akuzohet ai në
22 aktakuzën e konfirmuar dhe nuk ka qenë i pranishëm në Zllash
23 gjatë kohës në fjalë.

24 Nën dritën e sa më lart Trupi Gjykues konstaton se
25 dëshmitë e dëshmitarëve 100, 1800 dhe 2000 nuk kanë lidhje me

1 akuzat kundër të akuzuarit dhe prandaj nuk çojnë në
2 përcaktimin e të vërtetës. Duke e urdhëruar Mbrojtjen që t'i
3 heqë këta dëshmitarë nuk e dëmton të drejtën e të akuzuarit
4 për të paraqitur provat e veta.

5 Përkundrazi, Trupi Gjykses, autorizon Mbrojtjen që të
6 thërrasë dëshmitarët 200, 1700 dhe 1900 që propozohen në
7 listën e dëshmitarëve, aneksi F333 mbi bazën e dëshmimeve që do
8 të japin këta dëshmitarë dhe këto dëshmi kanë lidhje me akuzat
9 kundër të akuzuarit. Trupi Gjykses megjithatë mendon se koha e
10 përcaktuar për t'i marrë në pyetje këta dëshmitarë është e
11 tepruar. Trupi Gjykses vëren se Mbrojtja nuk ka barrën e
12 provës në këtë procedurë, në këtë proces gjyqësor dhe këta
13 dëshmitarë dhe provat dhe dëshmitë që duhet të japin ata duhet
14 të jenë të fokusuara dhe të lidhen me çështje të caktuara.

15 Prandaj, Trupi Gjykses mendon që është e përshtatshme që
16 t'i japi Mbrojtjes një total prej 36 orësh për pyetjet nga
17 pala thirrëse të këtyre 17 dëshmitarëve që janë të autorizuar
18 të japin dëshmi. Kjo kohë mund të ndahet pastaj midis këtyre
19 dëshmitarëve sipas gjykimit të Mbrojtjes. Megjithatë, Mbrojtja
20 nuk mund të kërkojë më shumë kohë për një dëshmitar të caktuar
21 dhe në qoftë se do të kërkojë më shumë kohë për një dëshmitar
22 të caktuar duhet të paraqesë arsye para Trupit Gjykses. Trupi
23 Gjykses mendon se caktimi i kohës duhet të jetë proporcional
24 me kohën e përgjithshme që është përdorur nga ZPS-ja në
25 marrjen në pyetje të dëshmitarëve të vet dhe përbën një

1 kompromis të drejtë që respekton të drejtën e të akuzuarit për
2 të paraqitur provat e veta para Panelit.

3 Paneli cakton të mërkurën, 23 mars, ora 09.30 si datën
4 për të filluar, pra në orën 09.30, si datën për të filluar
5 dëshminë e dëshmitarit të parë të Mbrojtjes, që është
6 dëshmitari 200.

7 Dëshmia e dëshmitarit 200 do të vazhdojë, nëse është e
8 nevojshme edhe të enjten me 24 mars në mëngjes për një seancë
9 nga ora 09.30 deri në 11.00 dhe të hënën me 28 mars në orën
10 09.30, duke filluar nga ora 09.30.

11 Dëshmia e dëshmitarit 200 do të vijojë menjëherë pas tij
12 - më falni - do të vazhdojnë menjëherë pas dëshmisë së
13 dëshmitarit 300, dëshmitarit 400 dhe dëshmitari 500 do të jetë
14 në pritje për të dhënë dëshmi mbas tyre.

15 Trupi Gjykses do të mbajë seanca nga 28 marsi deri me 31
16 mars, nga ora 09.30 deri në orën 16.00 çdo ditë.

17 Për javët në vijim në vartësi nga pushimet publike dhe
18 disponueshmërisë së sallës, Trupi Gjykses do të vazhdojë të
19 mbajë seanca tre herë në javë nga ora 09.30 deri në 16.00. Një
20 kalendar më i saktë do t'i jepet palëve në fund të kësaj jave.

21 Nën dritën e sa më lart, Trupi Gjykses urdhëron Mbrojtjen
22 që të dorëzojë deri të hënën me 14 mars 2022 një urdhër të
23 përditësuar për dëshminë e 17 dëshmitarëve me kohën e
24 përcaktuar për marrjen në pyetje nga Mbrojtja të secilit
25 dëshmitar të rillogaritur mbi bazën e 36 orëve që i është

1 dhënë Mbrojtjes.

2 Me kaq mbyllet urdhri i dytë.

3 Urdhri i tretë gojor përcakton disa afate për Mbrojtjen
4 me qëllim që të organizohen procedurat ashtu siç duhet.

5 Trupi Gjykses vëren se Mbrojtja ka bërë parashtrimin që
6 në këtë fazë nuk do të kërkojë pranimin e provave në bazë të
7 rregullave 153 dhe 155 të Rregullores, por mund të bëjë një
8 kërkesë për këtë më vonë.

9 Për këtë arsye Trupi Gjykses e urdhëron Mbrojtjen të
10 dorëzojë deri me 18 mars 2022, nëse ka kërkesë për pranim
11 materialesh sipas rregullave 153 dhe 155 të Rregullores ose
12 ndonjë rregull tjetër apo nen tjetër të Ligjit. Në qoftë se
13 Mbrojtja nuk do të kërkojë futjen e provave të tjera atëherë
14 nuk ka nevojë të bëjë parashtrime me shkrim.

15 Trupi Gjykses vëren gjithashtu parashtrimin e Mbrojtjes
16 se është në proces të vlerësimit nëse është e nevojshme të
17 kërkojnë masa mbrojtëse për një dëshmitar. Në lidhje me këtë,
18 Trupi Gjykses e urdhëron Mbrojtjen që të dorëzojë deri me 28
19 mars 2022 kërkesën për masa mbrojtëse në lidhje me këtë
20 dëshmitar. Në qoftë se ky dëshmitar në fjalë është ndonjë prej
21 dëshmitarëve 100, 1800 apo 2000, atëherë nuk ka nevojë që
22 Mbrojtja të paraqesë kërkesë në lidhje me të.

23 Trupi Gjykses vëren gjithashtu se Mbrojtja ka parashtruar
24 që mund të ketë materiale fotografike, deklarata apo prova
25 dokumentuese të cilat ende nuk janë nxjerrë. Por që në këtë

1 fazë Mbrojtja ende nuk mendon se ka një mundësi të tillë që do
2 të paraqesë materiale të tjera.

3 Në përputhje me rregullën 104(5) të rregullave dhe sipas
4 pikës 9(5)(a) të Rregullores, Trupi Gjykses urdhëron Mbrojtjen
5 që të nxjerrë çdo material që ka mbetur deri me 18 mars 2022
6 dhe në qoftë se Mbrojtja nuk dëshiron që të nxjerrë materiale
7 të tjera shtesë në këtë fazë nuk ka nevojë të bëjë asnjë
8 parashtrim.

9 Çdo dorëzim materialesh pas këtij afati më vonë duhet të
10 arsyetohet.

11 Këtu përfundon ky urdhër.

12 Urdhri tjetër ka të bëjë me parregullsitë që u
13 identifikuan dje nga Trupi Gjykses në lidhje me listën e
14 provave materiale të Mbrojtjes.

15 Trupi Gjykses mendon se organizimi i duhur dhe i rregullt
16 i provave të Mbrojtjes e ndihmon qartësinë dhe lehtëson
17 procedurat.

18 Kështu Trupi Gjykses e urdhëron Mbrojtjen që të shikojë
19 edhe një herë të gjithë listën e provave materiale si dhe
20 materialet që janë përfshirë në metadata në sistemin
21 elektronik në *Legal Workflow* dhe të sigurojë që gjithë
22 informacion është saktë. Këtë duhet ta bëjë deri të premtën 18
23 mars 2022. Në qoftë se ka nevojë për ndihëm për zbatimin e
24 urdhrin të Trupi Gjykses Mbrojtja instruktohet që të vendosë
25 lidhje të kontaktojë me Njësinë për Administrimin e Gjykatës.

1 Dhe çfarëdo problemi që mund të ketë ZPS-ja apo Mbrojtja e
2 Viktimave me këto materiale, duhet t'ia paraqesë Trupi Gjykses
3 deri me 18 mars 2022 dhe të lidhen menjëherë me Mbrojtjen për
4 t'i sqaruar këto çështje.

5 Këtu mbyllet edhe ky urdhër.

6 Urdhri i fundit ka të bëjë me shtojcën 1 të parashtrimin
7 të Mbrojtjes së Viktimave në lidhje me këtë konferencë për
8 ecurinë e çështjes. Duke pasur parasysh se jo e gjithë
9 përmbajtja e këtyre parashtrimeve duhet të ketë klasifikimin
10 *ex parte*, Trupi Gjykses urdhëron Mbrojtjen e Viktimave që të
11 dorëzojë deri me 18 mars 2022 një version të redaktuar
12 konfidencial të dokumentit F00334, shtojca 1 ose të japë
13 parashtrime se pse ky material duhet të mbajë klasifikimin *ex*
14 *parte*.

15 Me kaq mbyllet ky urdhër.

16 Tani do t'ia jap fjalën palëve nëse duan të ngrenë ndonjë
17 çështje tjetër të mëtejshme.

18 Prokuror?

19 Z. MICHALCZUK: [Përkthim] Ne nga Prokuroria nuk kemi
20 asnjë koment.

21 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]
22 Mbrojtësja e Viktimave?

23 ZNJ. PUES: [Përkthim] [Përmes videolidhjes] Jo,
24 faleminderit. Nuk kemi ndonjë vërejtjeje tjetër.

25 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Zyra

1 Administrative ka diçka për të thënë?

2 Z. NILSSON: [Përkthim] Jo, ne nuk kemi asgjë, e nderuar
3 Gjykatëse.

4 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]
5 Mbrojtja ka diçka për të thënë?

6 Z. VON BONE: [Përkthim] Jo, asgjë.

7 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]
8 Atëherë, do ta mbyllim sot seancën dhe do të vazhdojmë të
9 hënën me 21 mars, në orën 09.30.

10 I falënderoj të gjithë, përkthyesit, Sekretaren e
11 Gjykatës, të gjithë palët për pjesëmarrjen e tyre.

12 --- Seanca mbyllet në orën 16.31

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25